

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT "ERGYS M. SINANI"

Nr. 414 Prot
Nr. 105 Dosje

Tiranë, më 17/08/2020

URDHËR

(PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE)

- Drejtuar:** QËNDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Adresa: Bly "Zhan D`Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë
- Për dijëni:** Debitorit – Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. me NUIS - L72031013B
Adresa: Njesia Administrative Nr.5, Bulevardi Gjergj Fishta, Nr.48, Tiranë
- Për dijëni :** Kreditorit – Shoqëria "I.X.H.E.M." sh.p.k, me NUIS- K81921503A
Adresa :Rrashbull, Vrrinë, prane rruges se Fshatit Rinia, Durrës

Unë, Ergys M. Sinani , me detyrën e Përmbaaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 2474 Akti datë 18.6.2020 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbaarimore Nr.105 , datë 23.06.2020 kërkesën e kreditorit Shoqëria " I.X.H.E.M. " sh.p.k, ndaj debitorit Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., me NUIS - L72031013B në lidhje me titullin ekzekutiv "Faturën Tatimore me nr.serial 66481091 datë 11.04.2019 lëshuar sipas situacionit per kontraten e nensipermarrjes dt. 02.10.2018".

Pasi fillimisht u bë Lajmërimi për Ekzekutimin Vullnetar të detyrimit me shkresën Nr. 366 Prot, datë 23/06/2020 dhe nuk pati asnjë reagim nga ana e debitorëve, u fillua ekzekutimi i detyrueshëm, referuar nenit 517 të K.Pr.Civile.

Me Shkresën Nr. 385 Prot., datë 15/07/2020 është dërguar Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative për të kryer bllokimin e kuotave / aksioneve / aktiveve apo çdo të drejtë tjetër në subjektet tregëtare , që zotërohen dhe janë të regjistruar në emër të debitorit :

- 1) Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., me NUIS - L72031013B, me seli në adresën : Njesia Administrative Nr.5, Bulevardi Gjergj Fishta, Nr.48, Tiranë

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura

KONSTATOVA Se :

Më datë 15.8.2020 nga pala debitore është dërguar nga komunikimet elektronike me foto pagesa (SWIFT Kodi) e kryer për shumën detyrimit të mbetur në llogarinë e veçantë përmbaarimore të përmbaaruesit gjyqësor Ergys Sinani , pranë "Banka Kombetare Tregtare" sh.a me: IBAN – AL17 2051 1306 0023 27CL PRBL ALLP ne monedhen Lekë, siç është përcaktuar në shkresën Urdher për Vënine e Sekuestros Konservative me 412 Prot, datë 12/08/2020. Nga verifikimi i

Ilogarisë së veçantë përmbartimore rezulton se këto fonde janë bërë aktive në llogarinë bankare si më sipër, në datën 17.8.2020 pas mesdite

Përsa më sipër, kam proceduar me Vendim për Pushimin e Ekzekutimit Nr. 413 Prot. datë 17/08/2020, i cili me kalimin e afatit 5 ditor nga dita e njoftimit tek palët në proces, konsiderohet tashmë një veprim i formës së prerë.

Në këto kushte, referuar nenit 617 të K.Pr.Civile, nenit 37 pikat (b,c) të Ligjit Nr. 26/2019, datë 8.5.2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1) **Heqjen e masës së Sekuestros Konservative**, të vendosur me anë të shkresës Nr. 385 Prot., datë 15/07/2020 për bllokimin e kuotave / aksioneve / aktiveve apo çdo të drejtë tjetër në subjektet tregëtare, që zotërohen dhe janë të regjistruar në emër të debitorit:

- Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., me NUIS - L72031013B, me seli në adresën : Njesia Administrative Nr.5, Bulevardi Gjergj Fishta, Nr.48, Tiranë

2) **Të njoftohem dhe informohem** menjëherë në formë shkresore në lidhje me procedurën e heqjes së masës së sekuestros konservative nga ana Juaj.

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbartimor i referuar në K.Pr.Civile, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve.
- c) Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje.

PËRMBARTUESI GJYQËSOR

Ergys M. Sinani

